

Mbt: "WUS Austria" organizon garën studimore "Rasti sfidues i Kosovës"

# Fituesit shkojnë në garën finale në Vjenë

ANITA KADRIU

Prishtinë, 13 janar - Studentët kosovarë do të kenë mundësi që edhe këtë vit të dëshmojnë aftësitë e tyre në një garë me studentët nga vendet tjera evropiane. Organizuar nga "WUS Austria" për të pestën herë me radhë do të mbahet gara studimore "Rasti sfidues i Kosovës", në të cilën do të marrin pjesë studentët e Universitetit të Prishtinës, kurse fituesit e kësaj gare do të përfaqësojnë Kosovën në finalen - "Rasti sfidues i Ballkanit", që do të mbahet në Vjenë.

Udhëheqës i "WUS Austria", e cila financohet nga Agjencia Austriake e Bashkëpunimit, e kanë falenderuar këtë agjencjë përkrahjen dhe mundësin që studentët kosovarë edhe këtë vit të dëshmojnë dijen e

tyre. But Dedaj, udhëheqës i "WUS Austria" në Kosovë, tha se kjo garë synon hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja studentëve të shkëlqyeshëm duke i forcuar lidhjet në mes të edukimit dhe punësimit. Gjysmëfinalja e kësaj gare në Kosovë do të mbahet në disiplinat: simulimi i gjyqit; gara e rastit të biznesit; modelli i Këshillit të Evropës dhe teknologjia informative dhe komunikuese.

Studentët që kanë marrë pjesë në garën e Vjenës viteve të kaluara, kanë fituar bursa për studime nga kompani të njoitura botërore, përfaqësuesit e të cilëve kanë qenë prezantë në këtë garë. Kandidatët që aplikojnë për të marrë pjesë në "Rastin sfidues të Kosovës", sipas

kriterieve të përcaktuara duhet të jenë studentë të shkëlqyeshëm, të jenë në përfundim të studimeve në fushën e ekonomikut, drejtësisë, shkencave politike apo shkencave teknike. Seleksionimi i kandidatëve bëhet duke u bazuar në paraqitjen e

tyre akademike, aktivitetet jashtëmësimore si dhe njojjen e gjuhës angleze.

Afat i aplikimit do të zgjasë deri më 15 shkurt, dhe bëhet përmes postës elektronike në adresë të "WUS Austria".



14.01.2009 ; LADM ; fg. 8